



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 05 shtator 2012, në orën 10:00 sala N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci, dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON- auditor i përgjithshëm; Bedri Hamza- ministër i Ministrisë së Financave; Behxhet Haliti –ATK; Fatmir Plakiqi-Thesari dhe Naim Huruglica-Dogana e Kosovës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 28.08.2012 dhe 29.08.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Financave për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Administratës Tatimore të Kosovës, për vitin 2011;
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Doganës së Kosovës;
6. Planifikimi për sezonin e auditimit 2012/2013;
7. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 28.08.2012 dhe 29.08.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të mbajtur më 28.08.2012 dhe 29.08.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Financave për vitin 2011

Kryetari – Opinioni i auditimit për vitin 2011 për MF-në (opinionin e pakualifikuar), sipas raportit të ZAP-it, këtë vit janë dhënë 7 rekomandime që i adresohen menaxhmentit të MF-së, edhe atë: moskthimi me kohë dhe sipas marrëveshjes i kredisë së dhënë ndërmarrjeve publike-KEK-ut. Alokimi i shumave të mjeteve për Fondin për kuadro, duke mos respektuar udhëzimin për caktimin e kriterëve të përfituesëve të kësaj skeme. Plan i auditimit të MF-së në të ardhmen do të orientohet në mbikëqyrjen e menaxhimit financiar, kur dihet se Ministria e Financave ka dikasteret kryesore për menaxhimin e financave publike. Mangësitë në dokumentacion, sa i përket shpronësimit të pronave për autostradën Morinë-Merdar (pyetje kjo për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm). Lëshimet në çështje të prokurimit, si dhe pagesa e furnitorëve për çështje të furnizimit me veshmbathje zyrtare, mungesë e raportit të pranimit të mallit, furnizim me naftë, ndryshimi i çmimit të transportit, publikime për çështje të tenderëve etj. në shume gazeta, janë disa nga sfidat që ka vërejtur auditori gjatë auditimit në MF.

Ramiz Lladrovci – Përgëzoi MF-në për një punë shumë të mirë. Opinioni i ZAP-it është pozitiv. Është për t'u përgëzuar ministri edhe për adresimin e rekomandimeve nga viti i kaluar. Por, nevojitet një përqendrim më i madh në atë që buxheti i planifikuar të realizohet në masë më të madhe, si dhe të jetë këmbëngulës në kthimin e kredive.

Armend Zemaj – Pyeti: Cili është plani konkret për kthimin e kredisë nga KEK-u? Sipas auditorit, është shkëlur neni 80 i LMFP, sipas të cilit janë bërë pagesa të dyfishta, pastaj ka të gjetura te prokurimi, si dhe të gjetura rreth kthimit të avancit. Kjo po paraqitet si problem në vazhdimësi. Edhe skema pensionale, çështja e pagesave, duhet të shikohet. Ka zyrtarë qeveritarë, që marrin nga dy ose tri paga. Ligji lejon hapësire dhe këto duhet të rishikohen. Një kryetar komune merr pagën dhe në të njëjtën kohë merr edhe pagë nga një kategori e luftës apo invaliditetit. Ai Kërkoi sqarime lidhur me këtë. Vlerësimet e përgjithshme rrisin efikasitetin e menaxhimit të buxhetit të shtetit në tërësi dhe hapësira për kritika mbetet më e vogël nga viti i kaluar.

Bedri Hamza, ministër i Ministrisë së Financave – Falënderoi Komisionin për përkrahjen në eliminimin e defekteve në sistem. Të tri raportet në kuadër të MF-së kanë opinion të pakualifikuar. Pastaj pjesa më e madhe e rekomandimeve nga viti i kaluar është përmbushur, si dhe pasqyrat financiare janë prezantuar drejt, sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit. Ka vend për përmirësim dhe MF-ja ka bërë Planin e Veprimit për këto tri institucione dhe shumica janë implementuar, ndërsa pjesa tjetër do të adresohet deri në fund të vitit. Fillimi i kthimit të kredive, ka ndodhur. Është një shumë e madhe, por gjithmonë kemi analizuar nëse shteti duhet të kreditojë një ndërmarrje publike apo duhet ta trajtojë si subvencion apo investim kapital. Jemi duke punuar për të modeluar një zgjedhje dhe bashkë me ndihmën e ZAP-it dhe të komisionit, e ndoshta ky numër i kredive do të shndërrohet në një kredi të konsoliduar. Kontratat duhet të ndalohen. Sa i përket çështjes së fondit për kuadro, ai tha se ka pasur dilemë prej projektit fillestar, i cili ka qenë i financuar nga USAID-i dhe pastaj është bartur në institucion qeveritar. Njerëzve të këtij departamenti duhet t'ju bëhet pagë e rregullt dhe të shuhet fondi për kuadro. Kosova ka nevojë për një departament të makroekonomisë, por kjo duhet të bëhet pagë e rregullt.

Shpronësimi i pronave është proces kompleks dhe ka probleme të ndryshme, por ZAP-i nuk ka

dhënë rekomandim për të gjetura materiale.

Neni 80 i LMFP-së, janë disa komisione që janë të themeluara me ligj dhe me vendim të Qeverisë. Ne të kaluarën ka pasur pagesa të dyfishta për punë brenda orarit të punës. Këto raste janë eliminuar. Pastaj, rasti i anëtarëve të komiteteve të auditivit, të cilët kanë një pagesë simbolike. Nëse nuk kanë një pagesë, atëherë cili është motivi për të shtyrë punën e tij? Është e vërtetë që disa avanse nuk janë mbyllur. Fjala është për njërin avanc, që një anëtar i MF-së i ka humbur dokumentacioni. Kjo çështje tanimë është mbyllur.

Sa i përket marrjes së më shumë pagave nga i njëjti burim, ai tha se ka raste kur një paguhet për pagë të rregullt dhe në të njëjtën kohë merr pension si ish- pjesëtar i TMK-së. Ka raste të tilla, edhe pse nuk janë dukuri dhe këto raste do të eliminohen.

Rekomandimet ZAP-it janë marrë seriozisht dhe janë në implementim e sipër.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2011

Ali Sadriu – Opinioni i auditimit për vitin 2011, për ATK-në është opinion i pakualifikuar. Sipas raportit të ZAP-it, këtë vit janë dhënë 5 rekomandime që i adresohen menaxhmentit të ATK-së, edhe atë: në Zyrën e Personelit të ATK-së ka dallime të përshkrimit të pozitave të punës, sipas kontratave të punës me ato të dorëzuara në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) DASHC. Borxhet e vjetra të skaduara kapin shumën prej 73.7 milion euro, përveç kësaj pritet që edhe 6 milion euro të tjera të kalojnë afatin e 6 viteve, dhe nëse për këtë nuk janë iniciuar procedurat në Gjykata, e që llogariten si borxhe të këqija.

Komunikimi me Departamentin e Thesarit, MF dhe Bankat nuk ka qenë i mirë në kontest të inkasimit të borxheve për institucionet qeveritare.

Të hyrat nga qiraja, janë ende të pakta, qoftë për bizneset që kanë kontrata me institucionet, qoftë me sektorin privat.

Modifikimet në sistemin e SINTAGSIT, janë bërë për të dhënë informacione më të sakta për bizneset (mungonte saktësia e të dhënave) se si është situata tani pas modifikimeve të bëra në sistem.

Mursel Halilji – Në faqen 12 të raportit të auditimit, ku flitet për borxhet e vjetra të cilat Administrata Tatimore nuk ka mundur t'i mbledhë nga kompanitë private apo institucionet qeveritare, a është kjo si rezultat i mosbashkëpunimit të mirë në mes të ATK-së dhe Departamentit të Thesarit në Ministrinë e Financave? Si mendoni ta zgjidhni këtë çështje?

Valbona Dibra – Opinioni i pakualifikuar për ATK-në, na bënë të ndihemi mirë. Jam e interesuar për çështjen e bizneseve individuale, të cilat në momentin e regjistrimit janë si regjistrime individuale dhe në momentin e vdekjes së pronarit vdes edhe vetë biznesi. Si është e rregulluar kjo çështje në ATK tani?

Ramiz Lladrovci - Unë kisha kërkuar nga Drejtori i ATK-së, që të na ofrojë një listë specifike me emër të kompanive që janë në listën e borxheve prej 6 milionë euro.

Armend Zemaj – U interesua për çështjen e vonesave në rimbursim të mjeteve nga ATK-ja, si dhe për çështjen e borxheve të papaguara ndaj ATK-së, të cilat janë të larta. Si është e rregulluar kjo për sa i përket çështjes së tenderëve të kompanive, të cilët janë përfitues publikë që të mos kenë borxhe të papaguara ndaj ATK-së?

Behxhet Haliti, drejtor i ATK-së – Pasqyrat financiare të ATK-së i ka auditur ZAP-i dhe në bazë të kësaj ka dhënë disa rekomandime, të cilat janë në implementim e sipër.

Sa i përket çështjes së borxheve, janë borxhe që nga viti 2000, mirëpo ATK-ja, sipas një plani të aprovuar, një pjesë e këtyre borxheve ka qenë e pamundur të mbledhet, sepse pronarët kanë vdekur, ndërsa familjet e tyre jetojnë vetëm nga ndihmat sociale.

Po ashtu, ne po kërkojmë edhe nga instancat e Qeverisë dhe të Kuvendit, që borxhet e vjetra që

vijnë nga institucionet qeveritare apo ndërmarrjet publike që përbëjnë afër 30% të borxhit të përgjithshëm, të paktën nga viti 2005, të falen, me qellim që ATK-ja të merret me inkasimin e borxhit vetëm pas vitit 2005 e këtej. Ligji na lejon që ne t'i hulumtojmë vetëm borxhet të cilat nuk janë më të vjetra se 6 vite, ndërsa në këtë rast, ATK-së iu ka lehtësuar puna.

Të hyrat nga qiraja janë më të ulëta sesa që mundë të jenë realisht, mirëpo nëse kjo krahasohet me vitet paraprake kemi një rritje prej 40%, kjo nuk do të thotë se kemi rritje të normës së tatimit, mirëpo me këtë kemi zgjeruar bazën tatimore të tatimpaguesit e rinj.

ATK-ja, po ashtu ka zhvilluar modulet e kontrollit, ngritjen e sistemit të teknologjisë, ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në shqyrtimin e ankesave, sistemi online i deklarimit të tatimeve, deklarimit të TVSH-së, si dhe deklarimi online i kontributeve pensionale. Si pasojë e kësaj, 15 punëtorë kanë humbur vendin e punës, mirëpo ne do t'i sistemojmë aty ku kemi nevojë me të madhe për këta punëtorë.

Bizneset individuale, rasti i ndërrimit të pronarit ka të bëjë edhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, por sa i përket ATK-së, kjo çështje është rregulluar shumë mirë, sepse numri fiskal i tatimpaguesit korrespondon tani me numrin personal të letërnjoftimit.

Vonesat në rimbursime janë shumë më të vogla sesa ishin më parë. Një nga kriteret për matje të performancës së ATK-së ka qenë edhe ajo se sa ne mbledhim dhe sa ne jemi në gjendje të kthejmë, ku sipas kësaj ne kemi një progres në këtë drejtim.

Operatorët ekonomikë që i kanë borxhe institucioneve qeveritare, në këtë rast edhe vetë ATK-së, kjo çështje është në proces të zgjedhjes përmes Departamentit të Thesarit në MF dhe qendrën e regjistrimit të automjeteve, në mënyrë që këto të fundit të na japin informata të sakta dhe shumë të shpejta për bizneset e caktuara.

Kohëve të fundit kemi sulme ndaj personelit të ATK-së në vendin e punës. Kemi kërkuar nga Policia dhe Prokuroria që këto çështje t'i shqyrtojnë me kohë dhe të trajtohen si raste të sulmit ndaj institucionit.

Mosharmonizimi i përshkrimit të pozitave të punës së ATK-së në personel dhe në MAP-Divizioni i Pagave, është çështje teknike dhe nuk ka ndonjë ndikim financiar, edhe pse kjo është në procedurë për përmirësim.

Po ashtu, çështja e pajisjeve me arka fiskale është realizuar afër 85 % e tatimpaguesve, ngecje të vogla ka tek tatimpaguesit e vegjël që kanë kuotën e pagesave tremujore prej 37.5 euro. Ne po mendojmë se këtyre tatimpaguesve t'ju ndihmohet qoftë në furnizim me arka fiskale, qoftë me pagesë të abonimit për mirëmbajtjen e arkave.

Shpenzimi i buxhetit ka qenë i mirë, mirëpo afër 75% e buxhetit shpenzohet për paga dhe mëditje.

Pragu i TVSH-së është ashtu siç ka qenë fillimisht, deri në 50,000 euro qarkullim vjetor, po ashtu jemi duke punuar në atë drejtim që pragu i TVSH-së të zbritet.

Kryetari Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për pikën tre, katër dhe pesë të rendit të ditës, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- ***Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Financave, Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës, për vitin 2011 nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.***
- ***Lidhur me këto raporte, Komisioni do ta njoftojë Kuvendin bashkë me Raportin vjetor të auditimit.***

5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Doganës së Kosovës

Ali Sadriu- Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike i Kuvendit inkurajon Doganën në të arriturat në inkasimin e të hyrave, si dhe një performancë të mirë të treguar në shpenzimin e parasë publike. Opinioni i auditimit për vitin 2011 për Doganën, është opinionin i

pakualifikuar. Këtë vit janë dhënë 3 rekomandime që i adresohen menaxhmentit të Doganës. Performancë e mirë në mbledhjen e të hyrave për vitin 2011 shprehur në përqindje prej 99.53% e planit, përkundër disa lëshimeve të ndodhura në procesin e regjistrimit të të hyrave. Përkundër faktit se Dogana ka regjistruar pasurinë në modulën e regjistrimit të pasurisë në sistemin e menaxhimit financiar, auditori ka vërejtur parregullsi në çështjen e zhvleftësimit dhe vlerat e paraqitura nuk pasqyrojnë gjendjen reale. Sektori i ankesave të Doganës ka pasur vonesa në dhënien e përgjigjeve, sipas afateve të parapara, dhe për këtë rekomandohet drejtori i doganave që të marrë të gjitha masat në përmirësimin e këtij shërbimi.

Ramiz Lladrovci – Inkurajoi Doganën për të arriturat në çështjen e mbledhjes së të hyrave, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm të funksionimit të institucioneve, përkundër disa pengesave. Edhe pse jashtë rendit të ditës, pyeti nëse Dogana e Kosovës ka paraparë trajnime për sjelljen-etikën e doganierëve, kjo për faktin se ka ankesa rreth sjelljeve të zyrtarëve doganorë në pikat kufitare. Pastaj duhet pasur parasysh faktin se imazhi i shtetit vërehet pikërisht në pikat kufitare.

Valdete Krasniqi, drejtore e Buxhetit dhe Financave të Doganës – ZAP-i ka bërë auditimin e Doganës dhe se bashkëpunimi ynë me zyrtarët e ZAP-it ka qenë shumë i mirë.

Pasuria e regjistruar – në pasqyrat financiare dhe mosllogaritja e normës së zhvleftësimit nga ana e zyrtarit të pasurisë që tani ato pajisje kanë vlerën zero, Dogana ka marrë të gjitha masat që kjo çështje të rregullohet me ndihmën e Departamentit të Thesarit në MF.

Vonesat në ankesa – Dogana ka sektorin e veçante të ankesave. Është e vërtetë se ka vonesa në përgjigje të ankesave, mirëpo duhet të kuptohet se duhet të analizohen me të gjitha dëshmitë që lënda të kompletohet. me qëllim që të merret vendimi në formë të drejtë dhe në kohë të duhur. Po ashtu edhe palët në disa raste hezitojnë të sjellin dëshmitë e kërkuara nga ana e zyrtarëve të Doganave.

Dogana mban trajnime të ndryshme për stafin e saj, po ashtu edhe sa i përket kodit të mirësjelljes. Në raste kur ka vërejtje për sjelljet jo të mira, veprohet në mënyrë shumë të shpejtë, sepse janë dy sektorë përbrenda Doganës, të cilët kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e zbatimit të plotë të kodit të mirësjelljes.

6. Planifikimi për sezonin e auditimit 2012/2013

Kryetari – Plani nga ZAP-i, i është dorëzuar Komisionit për propozime eventuale. Hapi diskutimin.

Kryetari – Veprimtaria e KOST-it është shumë e rëndësishme, dhe ZAP-i duhet patjetër të bëjë një auditim të KOST-it. Këtë vit ZAP-i nuk ka bërë një auditim të tillë, dhe kjo duhet të jetë një prej problemeve që duhet audituar çdo vit.

Ramiz Lladrovci – Komisioni duhet të bëjë një listë prioritare të OB-ve, në mesin e KOSTT-it, por në këtë rast nuk shoh shumë që mund të marrim informacione në auditim të rregullsisë, por të performancës. Komisioni duhet të vendos për prioritetet që duhet kërkuar nga ZAP-i. Pavarësisht buxhetit të OB-ve, duhet të auditohet, sepse edhe OB-të, me buxhet të vogël mund të bëjnë keqpërdorime.

Armend Zemaj – Zyra e Auditorit duhet të japë përparësi auditimit të OB-ve, të cilat janë të obliguara që deri më 31 mars të raportojnë në Kuvend, në mënyrë që pastaj në mbledhje plenare të prezantohen bashkërisht, pastaj raportet që janë paraparë, të raportohet në fund të qershorit.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm - Auditimin që ZAP-i po planifikon për vitin 2013/2014, fillimisht ka të bëjë me auditimet e detyrueshme me ligj, por problem përbën Komisioni i Inteligjencës, pastaj janë komunat, në të cilat ZAP-i planifikon të gjitha, nga 18 në

14 numri i komunave që do të auditohen nga kompani private. Auditime të detyrueshme me ligj, ku auditori mund të zgjedhë. Aty janë ndërmarrjet publike dhe sipas ndryshimeve në ligj, ZAP-i kryen auditimin e pasqyrave vjetore financiare të tyre dhe nëse nuk bën këtë ZAP-i, atëherë duhet njoftuar MZHE-ja për të kryer auditim nga kompani private. ZAP-i po planifikon auditimin e një kompanie e kjo është TREPÇA. Pastaj, vijmë te organizatat sekondare buxhetore, që janë auditime jo të detyrueshme me ligj.

Sa i përket auditimit të performancës, ai tha se pres me padurim pikëpamjet e komisionit.

Sfida është deri më 30 mars, kur edhe marrim pasqyrat vjetore financiare. Dhe, atyre pasqyrave duhet dhënë një opinion. Për të pasur një opinion më herët, atëherë duhet të ndryshohet ligji.

Kryetari Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të përfshijë në planin e auditimit edhe auditimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT-it.*
- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, gjatë auditimit, të marrë për bazë afatet kohore të organizatave buxhetore për raportim në Kuvend, në mënyrë që në mbledhje plenare për shqyrtim të procedohen bashkërisht raportet vjetore të punës bashkë me opinionin e auditorit të përgjithshëm.*

4. Të ndryshme

Diskutim rreth shqyrtimit të raporteve të auditimit të komunave

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Vendim

Më 17 dhe 18 shtator 2012, Komisioni për Mbikëqyrje e Financave Publike organizon punëtori jashtë ndërtesës së Kuvendit, për shqyrtimin e raporteve të auditimit të komunave.

Shpenzimet për organizimin e kësaj punëtorie barten nga buxheti i Komisionit.

Më 24 shtator 2012, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike organizon dëgjim publik, për shqyrtimin e raporteve të auditimit të komunave, sipas përfundimeve që dalin nga punëtorja e organizuar më 17 dhe 18 shtator 2012.

Për shkak të numrit shumë të madh të pjesëmarrësve, dëgjimi publik organizohet jashtë ndërtesës së Kuvendit.

Shpenzimet për organizimin e dëgjimit publik, më 24 shtator 2012, barten nga KIPRED-i.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu